

20191903007

LIGJ PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe procedura për dhënie të provimit të jurisprudencës (në tekstin e mëtejme: provimi).

Neni 2

Provimi jepet për kontroll të aftësisë profesionale të personave që kanë kryer arsim të lartë katërvjeçar të studimeve juridike VII/1, si dhe personat që kanë studiuar studime juridike sipas Deklaratës së Bolonjës dhe kanë 300 kredi sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) (në tekstin e mëtejme: juristët e diplomuar) për zbatim të pavarur të rregullave në praktikë dhe kryerjen e punëve juridike për të cilat me ligj është paraparë ky kusht.

Neni 3

Gjykatat, prokuroritë publike, avokatët, noterët, përmbaruesit, Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të pranojnë në praktikë juristë të diplomuar, nëse praktika u nevojitet për aftësim profesional dhe për arritje të kushteve për dhënie të provimit.

II. KUSHTE DHE MËNYRA E REALIZIMIT TË PROVIMIT

Neni 4

(1) Provimin mund ta japin juristë të diplomuar që kanë punuar së paku një vit në punë juridike në gjykatë, prokurori publike, Avokati Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, te Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, avokat, noter ose përmbarues.

(2) Provimin mund ta japin edhe juristë të diplomuar që kanë punuar së paku dy vjet në punë juridike në organe tjera shtetërore, organe të njëjësive të vetëqeverisjes lokale, shoqëri tregtare dhe persona tjerë juridikë.

(3) Koha e kaluar në praktikë për aftësim profesional në gjykatë, prokurori publike, Avokati Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, te Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, avokat, noter ose përmbarues, në pajtim me ligjin, konsiderohet si kohë e kaluar në punë në ato organe.

(4) Kandidatët duhet t'i përmbushin kushtet nga paragrafët (1) ose (2) të këtij neni më së voni deri në ditën e pestë të muajit në të cilin realizohet sesioni.

(5) Ndalohet dhënia e provimit para kohe.

Neni 5

(1) Provimi përbëhet prej pesës me shkrim dhe me gojë.

(2) Pjesa me shkrim jepet për lëndët E drejta penale dhe Civile.

(3) Pjesa me gojë jepet për lëndët:

- E drejta penale (e drejta materiale penale dhe procedurale),
- E drejta Civile (e drejta materiale civile dhe procedurale).
- E drejta tregtare,
- E drejta e punës,

- Rregullimi kushtetues i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut,

- organizimi i sistemit të jurisprudencës dh të drejtës administrative dhe

- konflikti i ligjeve dhe ndihma juridike ndërkombëtare.

(4) Programin për dhënie të provimit e përcakton ministri i Drejtësisë dhe i njëjti publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(5) Programi nga paragrafi (4) i këtij neni i përmban rregullat, literaturën juridike dhe pyetjet e provimit.

(6) Programin nga paragrafi (4) i këtij neni e përgatit komisioni i formuar nga ministri i Drejtësisë.

Neni 6

(1) Provimi jepet para komisionit të provimit (në tekstin e mëtejme: Komisioni) që përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë dhe zëvendës të tyre.

(2) Kryetari, anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre i emëron ministri i Drejtësisë nga radhët e profesorëve të së drejtës nga fakultete të akredituara juridike në shtet, gjykatësve, prokurorëve publikë dhe avokatëve, me aktvendim me të cilin janë caktuar lëndët për të cilat ata pyesin.

(3) Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit është dy vjet me të drejtë të rizgjedhjes pas kalimit të së paku pesë viteve nga mandati i mëparshëm.

(4) Mandati i zëvendëskryetarit dhe zëvendësanëtarëve të Komisionit është dy vjet me të drejtë të rizgjedhjes.

Neni 7

(1) Punët profesionale dhe administrative për nevojat e realizimit të provimit i kryen Ministria e Drejtësisë, për të cilat ministri i Drejtësisë cakton person përgjegjës -sekretar të Komisionit.

(2) Ministri i Drejtësisë formon Komision për përcaktimin e përmbushjes së kushteve për dhënie të provimit, të përbërë nga tre të punësuar në Ministrinë e Drejtësisë që konstaton nëse kandidati i përmbush kushtet për dhënie të provimit.

(3) Kryetari i Komisionit për përcaktim të përmbushjes së kushteve për dhënie të provimit është sekretari i Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 8

Provimi jepet në sesionin e provimit të shkurtit, prillit, qershorit, tetorit dhe dhjetorit.

Neni 9

(1) Kërkesën për dhënie të provimit kandidati e parashtroi në Ministrinë e Drejtësisë.

(2) Me kërkesën për dhënie të provimit kandidati është i detyruar që të parashtrojë dëshmi për përmbushjen e kushteve për dhënie të provimit, të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 10

(1) Kandidati është i detyruar që ta paraqesë pjesëmarrjen në sesionin e provimit nga dita e parë deri në ditën e 15 në muajin i cili i paraprin muajit në të cilin mbahet sesioni i provimit (janar, mars, maj, shtator dhe nëntor).

(2) Kandidatit doemos duhet t'i mundësohet të fillojë të japë provimin në sesionin e parë të ardhshëm nga dita e kërkesë së miratuar për dhënie të provimit.

(3) Kandidatët informohen për datën, kohën dhe vendin e dhënies së provimit së paku dhjetë ditë para mbajtjes së provimit përmes ueb faqes së Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 11

(1) Komisioni për përcaktimin e përmbushjes së kushteve për dhënie të provimit në afat prej pesë ditësh nga dita e mbarimit të paraqitjes përgatit procesverbal i cili përmban listë të personave që i përmbushin dhe nuk përmbushin kushtet për dhënie të provimit.

(2) Nëse kandidati nuk i përmbush kushtet për dhënie të provimit, sekretari i Komisionit nga neni 7 paragrafi (1) i këtij ligji, në bazë të procesverbalit të Komisionit për përcaktimin e përmbushjes së kushteve për dhënie të provimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, me aktvendim vendos për refuzimin e kërkesës për dhënie të provimit.

(3) Kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar kërkesa për dhënie të provimit nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të ngritët kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Neni 12

(1) Nëse lënda përbëhet prej pjesës me shkrim dhe me gojë, kandidati doemos duhet fillimisht ta japë pjesën me shkrim që të fillojë ta japë pjesën me gojë.

(2) Në pjesën me shkrim të provimit kandidati zgjidh rast të caktuar të praktikës (lëndë të arkivuar gjyqësore) me zbatim të rregullave nga sfera adekuatë.

(3) Koha për zgjidhjen e rastit të praktikës, veç e veç për çdo lëndë, është nga katër orë pandërprerë.

(4) Në pjesën me shkrim të provimit është i pranishëm detyrimisht anëtari i Komisionit ose zëvendësi i tij që e testojnë lëndën konkrete dhe sekretari i Komisionit.

(5) Rezultatet nga pjesa me shkrim publikohen në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë në afat prej pesë ditësh nga dita e dhënies së provimit.

Neni 13

(1) Para fillimit të dhënies së provimit, sekretari i Komisionit e përcakton identitetin e kandidatit me shikim në dokumentin për identifikim personal.

(2) Gjatë dhënies së pjesës me shkrim të provimit kandidati mund të shërbehet vetëm me ligje dhe rregulla tjera në të cilat nuk janë përfshirë sqarime, komente dhe ngjashëm dhe nuk mund të përdoren telefona celularë, kompjuterë portativë dhe mjete tjera teknike dhe informative.

(3) Kandidatit gjatë dhënies së provimit nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë tjerë.

(4) Nëse kandidati gjatë dhënies së provimit vepron në kundërshtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, nuk do t'i lejohet dhënie e mëtejme e provimit në atë sesion të provimit dhe i shqiptohet ndalim për dhënie të provimit në kohëzgjatje prej një viti, me ç'rast ministri i Drejtësisë miraton aktvendim.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni mund të ngritët kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

(6) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni konsiderohet se kandidati nuk e ka dhënë provimin dhe i njëjti konstatohet në procesverbalin për dhënie të provimit.

(7) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, ndalimi shënohet në dosje personale të kandidatit dhe evidencën e Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 14

(1) Pjesa me gojë e provimit realizohet më së voni në afat prej 14 ditësh nga dita e mbarimit të provimit të fundit me shkrim.

(2) Pjesa me gojë e provimit është publike dhe realizohet para së paku tre anëtarëve të Komisionit nga të cilët njëri është testuesi për lëndën konkrete.

(3) Në provimin me gojë për çdo lëndë kandidati përgjigjet në tri pyetje të cilat i tërheq nga pyetjet e përgatitura paraprakisht. Çdo listë përmban vetëm një pyetje. Testuesi dhe anëtarët e pranishëm të Komisionit mund t'i parashtrojnë kandidatit pyetje plotësuese për vlerësim të njohurisë së tij të përgjithshme nga sfera e caktuar.

(4) Pas mbarimit të ditës së provimit, anëtarët e Komisionit që e kanë realizuar provimin me shumicë votash vendosin nëse kandidati e ka dhënë ose nuk e ka dhënë provimin për lëndën.

(5) Nëse lënda përbëhet prej pjesës me shkrim dhe me gojë, konsiderohet se është dhënë nëse janë dhënë të dy pjesët nga lënda.

(6) Mënyrën e dhënies së provimit e përcakton ministri i Drejtësisë.

Neni 15

(1) Kryetari i komisionit në bazë të procesverbalit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të cilët e kanë realizuar provimin, më së voni në afat prej pesë ditësh nga dita e mbarimit të provimit për të gjitha lëndët, publikisht shpall nëse kandidati e ka dhënë provimin ose nuk e ka dhënë, në bazë të rezultateve të përgjithshme për secilën lëndë veçmas.

(2) Ministria e Drejtësisë kandidatit i cili e ka dhënë provimin i jep certifikatë për provimin e dhënë të jurisprudencës në afat prej 30 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Formën dhe përmbajtjen e certifikatës nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton ministri i Drejtësisë.

Neni 16

(1) Kandidati e paraqet dhënien e të gjitha lëndëve ose numër të caktuar të lëndëve me zgjedhjen e tij në një sesion të provimit.

(2) Provimi konsiderohet i dhënë nëse në afat prej një viti duke filluar nga sesioni i parë i provimit kandidati i jep të gjitha provimet.

(3) Kandidati i cili nuk do të japë lëndë të caktuar, mund të paraqitet në provim korrigjues në sesionin e ardhshëm në afat nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Nëse kandidati nuk e ka dhënë provimin që përbëhet nga pjesa me shkrim dhe me gojë, provimin korrigjues për atë lëndë e jep me shkrim dhe me gojë.

(5) Nëse kandidati nuk i jep të gjitha lëndët në afat nga paragrafi (2) i këtij neni, konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin dhe mundet sërish ta japë provimin në tërësi.

Neni 17

(1) Kandidati i cili nuk do të vijë në ditën e caktuar për dhënien e provimit ose para fillimit të provimit deklaron se heq dorë nga dhënia e provimit, konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

(2) Nëse kandidati e ka filluar dhënien e provimit, i është ndarë rasti nga praktika ose i ka tërhequr pyetjet, pa shkaqe të arsyeshme (sëmundje, fatkeqësi, rast vdekje në familje dhe ngjashëm) heq dorë nga provimi, konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin e lëndës.

Neni 18

(1) Nëse gjatë dhënies së provimit ndodhin shkaqe të arsyeshme (sëmundje, fatkeqësi, rast vdekje në familje dhe ngjashëm) për shkak të së cilave kandidati nuk mund ta vazhdojë dhënien e të njëjtit, provimi do të ndërpritet për kohë të caktuar, që nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë muaj.

(2) Koha e ndërprerjes së provimit nuk llogaritet në afatin nga neni 16 paragrafi (2) i këtij ligji.

(3) Për ndërprerjen e provimit dhe vendimin për arsyeshmërinë e shkaqeve për ndërprerjen e provimit nga paragrafi (1) i këtij neni, vendos Komisioni me shumicë votash nga të gjithë anëtarët në bazë të kërkesës me shkrim të kandidatit.

(4) Kandidati me kërkesë të Komisioni në afat prej tetë ditësh nga dita e ndërprerjes së shkaqeve për prolongimin e provimit, por më së voni në afat prej gjashtë muajsh mund të kërkojë vazhdimin e dhënies së provimit për çfarë vendos Komisioni.

(5) Nëse kandidati në afat nga paragrafi (4) i këtij neni nuk parashtron kërkesë për vazhdimin e dhënies së provimit do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.

(6) Kundër vendimit të Komisionit nga paragrafi (4) të këtij neni, kandidati ka të drejtë kundërshtimi te ministri i Drejtësisë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

(7) Në vazhdimin e provimit, kandidati nuk e jep atë pjesë të provimit që e ka dhënë deri në prolongim.

Neni 19

(1) Sekretari i Komisionit ka për detyrë të mbajë procesverbal për rrjedhën e dhënies së provimit për secilën lëndë për çdo kandidat në të cilin detyrimisht futen të dhëna për: emrin dhe mbiemrin e kandidatit, numrin unik amë të qytetarit, përbërjen e Komisionit, anëtarët e pranishëm të Komisionit për dhënien e provimit të lëndës, datën, kohën dhe vendin e dhënies së provimit të lëndës, pyetjet e provimit që kandidati i ka tërhequr, pyetjet plotësuese që i janë parashtruar kandidatit dhe prej cilit anëtar të Komisionit, vendimin e Komisionit nëse kandidati e ka dhënë provimin ose nuk e ka dhënë provimin dhe vërejtje tjera më të rëndësishme për rrjedhën e provimit.

(2) Ministria e Drejtësisë mban evidencë për dhënien e provimit që ruhet në mënyrë të përhershme.

(3) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për dhënien e provimit i përcakton ministri i Drejtësisë.

III. SHPENZIME PËR DHËNIEN E PROVIMIT, E DREJTA E KOMPENSIMIT DHE MBIKËQYRJES

Neni 20

(1) Ministria e Drejtësisë i përcakton shpenzimet për dhënien e provimit që i përfshin shpenzimet reale për realizimin e provimit (angazhimi i sallës për dhënien e provimit, përgatitja e materialeve për dhënien e provimit, kompensimi për anëtarët e Komisionit, botimi dhe lëshimi i certifikatave, e ngjashëm).

(2) Shpenzimet për dhënien e provimit dhe provimit korrigjues i bart kandidati nëse institucioni ku është i punësuar nuk i paguan.

(3) Kryetari, anëtarët dhe sekretari i Komisionit dhe anëtarët e Komisionit për përcaktimin e përmbushjes së kushteve për dhënien e provimit kanë të drejtë kompensimi për punën e tyre, lartësinë e të cilit e cakton ministri i Drejtësisë si përqindje e shpenzimeve të bëra reale për dhënien e provimit.

(4) Të drejtë kompensimi për punën në Komision ka edhe zëvendësanëtari i cili merr pjesë në realizimin e provimit në vendin e anëtarit.

(5) Shpenzimet për dhënien e provimit paguhen në llogarinë e të ardhurave personale të Ministrisë së Drejtësisë.

(6) Nëse shpenzimet nuk janë paguar në llogarinë përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë më së voni 15 ditë para ditës së caktuar për fillimin e sesionit të provimit, kandidatit nuk do t'i lejohet dhënia e provimit.

(7) Nëse kandidati në afat prej një viti nga dita e pagesës së mjeteve nuk e jep provimin, mjetet e paguara kthehen në pajtim me ligjin.

(8) Pagesa e kompensimit në para nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, kryhet nga llogaria e të hyrave të veta të Ministrisë së Drejtësisë nga pagesa e mjeteve të kandidatëve që e japin provimin.

Neni 21

Anëtarët e komisionit nga neni 5 paragrafi (6) të këtij ligji për punën e kryer kanë të drejtë kompensimi të njëhershëm prej një rroge mesatare neto mujore të paguar në Republikë në tre muajt e fundit.

Neni 22

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Ministria e Drejtësisë.

Neni 23

(1) Gjohë në shumë prej 100 deri në 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kandidatit i cili vepron në kundërshtim me nenin 13 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj procedurë të kundërvajtjes mban dhe sanksion të kundërvajtjes shqipton gjykata kompetente.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Provimi i jurisprudencës që është dhënë sipas rregullave në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji barazohet me provimin në kuptim të këtij ligji.

Neni 25

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej dy muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 26

(1) Nga 1 janari 2020 shfuqizohet Ligji për provimin e jurisprudencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 137/13 dhe 153/15).

(2) Provimet që deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë filluar, do të përfundojnë në pajtim me Ligjin për provimin e jurisprudencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 137/13 dhe 153/15).

(3) Provimet që janë paraqitur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e dhënia e të cilëve nuk ka filluar, do të realizohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", e do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2020.